



26 nëntor 2013, Prizren

### KOMUNIKATË PËR MEDIA

#### Komuna e Mamushës të siguroj vlerë të shtuar për Festivalin e Domates

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Mamushës, EC Ma Ndryshe gjatë muajit nëntor ka shqyrtuar çështjen e shpenzimeve të qeverisë komunale në lidhje me organizimin e Festivalit të Domates.

Në saje të dhënave zyrtare del se Komuna e Mamushës për organizimin e Festivalit të Domates në vitin 2013 ka shpenzuar afër 15 mijë euro. Shuma e njëjtë e mjeteve është harxhuar edhe për edicionin e vitit 2012.

Bazuar në faturat e shpenzimeve për vitin 2013, 5.210 euro janë paguar për transportin me aeroplan nga Stambolli në Prishtinë, pastaj transportin me autobusë në relacionet Prishtinë-Mamushë dhe Mamushë-Prizren, si dhe rregullimin e binës, ndriçimit dhe zërimit. Ndërsa 3.294 euro ka kushtuar akomodimi i mysafirëve, derisa ushqimi dhe materialet promovuese kanë kushtuar 6.485 euro.

EC Ma Ndryshe është në dijeni se Festivali i Domates është njëra nga ngjarjet kryesore në këtë komunë, ku bujqësia është njëra nga veprimtaritë më të rëndësishme ekonomike. Prandaj, përhëndet dhe inkurajon autoritetet komunale që të ndërmarrin aktivitete që promovojnë produktet bujqësore të kësaj ane, por edhe vet imazhin e komunës së re.

Mirëpo, duke marrë parasysh shumën e mjeteve të harxhuara, pra 15 mijë euro, që përputhet me shifrën që Komuna e Prizrenit i ndan për "Dokufestin", si një ngjarje kulturore e nivelit ndërkombëtar, atëherë EC Ma Ndryshe konsideron se Komuna e Mamushës duhet të bëjë përpjekje më të mëdha që për këtë shumë të parave të siguroj vlerë më të shtuar për publikun.

Ky konstatim bazohet edhe në faktin se të hyrat komunale të Mamushës në vitin e kaluar kanë qenë të kufizuara, pra rreth 43 mijë euro, që nënkupton se shpenzimet për organizimin e këtij festivali kalojnë një të tretën e të hyrave vetanake.

Bazuar në këto të gjetura, EC Ma Ndryshe rekomandon komunën e Mamushës që të:

- Sigurohet se paratë e harxhuara do të sjellin vlerë të shtuar për Komunën dhe banorët e Mamushës, duke promovuar lokalitetin dhe produktet bujqësore me aktivitete cilësore dhe gjithëpërfshirëse që do të ndikojnë edhe në lidhjen e marrëveshjeve respektivisht rritjen e shitjes së domateve dhe produkteve tjera bujqësore;
- Bashkëpunoj me Shoqërinë Civile dhe Ministrinë e Bujqësisë rreth organizimit të Festivalit; dhe
- Publikoj thirrje për propozime për konceptin dhe organizimin e Festivalit, për çdo edicion.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeveritë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunës së Prizrenit dhe Mamushës" prej muajit maj 2013 përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*